



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 07 prot.

Himarë, më 09.06, 2025

**Lënda: PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË
ZBARDHUR NGA ORGJINALI, I MBAJTUR MË DATË 09.06.2025 PËR
MBLEDHJEN E RADHËS TË MUAJT MAJ**

Sot më datë 09.06.2025, zhvillohet mbledhja e radhës për muajin maj e Këshillit Bashkiak Himarë, ora 12:00 (mbledhja ishte njoftuar zyrtarisht për në orën 10:30 por me propozim të kryesisë u shty për në orën 12:00, me arsye që të rimblidheshin përsëri komisionet e këshillit për të shqyrtuar materialet e rendit të ditës)

Marrin pjesë këshilltarët: 1.Afrovita Dhhimojani, 2.Lenica Kocani, 3. Silva Burbo, 4. Miltiadh Prifti, 5. Timoleo Gërdhuqi, 6. Fuat Mati, 7. Thëllëza Kokaveshi, 8.Mirka Gjiçali, 9. Elisabeta Lamaj , 10. Nikolin Laska, 11. Dhimitër Kapaj, 12. Artionil Shirokaj, 13.Nertila Husi, 14.Artan Bala, 15.Qirjako Mërkuri, 16. Maks Vlashi, 17. Milto Nika, 18.Aleks Llazari.

Mungojnë : Loreta Isufi , Gjergji Iladhi, Thodhori Foto (me arsye)

Të ftuar : Kryetari Bashkisë, administratorët e njësive, drejtoritë e bashkisë, kryetarët e fshatrave, nënkryetarët e Bashkisë.

Mbledhjen e hap drejtuesi i Këshillit z.Dhimitër Kapaj

Miratohet rendi ditës.

Lexohet ligjshmëria e vendimeve të mbledhjes së muajt prill.

Pika 1 e rendit të ditës.

Shqyrtimi i dy ndihmave ekonomike për muajin mars dhe prill.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani : Pse nuk trajtohen me ndihmë edhe në njësinë Horë – Vranisht, nuk shohim këtu. Sqaron drejtoria përkatëse, çdo kërkesë që ka marr ose fituar kriteret , pikët është trajtuar me ndihmë .

Këshilltarja Silva Burbo :Pse është shumë kaq e vogël e kemi diskutuar edhe herë të tjera nuk mund të ngrihet si shumë , verë bashkia nuk ka ligj vendor për të përcaktuar këtë shumë ?

Sqaron drejtoria përkatëse : këto tarifa nuk i përcakton bashkia , be procedojmë sipas një plani dhe ligji nga ministria.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi : Po flisni për ndihmën ekonomike apo për ndihmën sociale , sepse për ndihmën sociale e kemi ngritur dhe herë të tjera si çështje , kur të bëjmë buxhetin duhet të nxjerrim një fond dhe ta miratojmë , sepse çdo bashki jep ndihmë sociale , vetëm bashkia jonë jo.

Këshilltari Milto Nika: Përkrahja sociale ka disa kritere , Pse në njësinë Lukovë nuk marrin apo nuk i zë ligji ata në bazë të disa kritereve nuk e përfitojnë , duhet të krijohet një fond për ata që nuk i plotësojnë kushtet por me të vërtet kanë nevojë për ndihmë .

Këshilltarja Silva Burbo : Unë di dhe njohë njerëz që kanë nevojë për përkrahje, janë nevojë për asistencë sociale , duhet të trajtohen.

Këshilltari Fuat Mati : Në rend të ditës në çdo mbledhje ndihma ekonomike duhet të çohet e para dhe e dyta duam të kemi djeni për çdo vendim që merr këshilli sa zbatohen nga drejtorit përkatëse, duam të na vijne në këshill me raport .

Kryetari këshillit : I hedhim në votim ndihmat ekonomike

Miratohet ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% I bllok – ndihmës ekonomike për muajin mars me nr. 22 vendimi , me 18 vota pro.

Miratohet ndihma ekonomike nga fondi 6% I bllok ndihmës ekonomike për muajin prill me nr.23 vendimi, me 18 vota pro

Pika 1 dhe 2 e rendit të ditës u miratuan sëbashku.

Pika 3 e rendit të ditës.

Relacioni i treguesve ekonomike për katër mujorin e parë për vitin 2025 , të Bashkisë Himarë.

Këshilltarja Silva Burbo:- këtë informacion e kemi si këshill por duam të jenë më të shtjelluar si psh, disa tabela sepse nuk i kuptojmë mirë , tek tabelat me të ardhura të trashëguara, te debitorët , duam një shpjegim më të detajuar. Mungon me arsye drejtori financës që do të raportonte materialin. Sqaron Kryetari Bashkisë. Kryetari këshillit : meqenëse mungon drejtori financës e lëmë për diskutim në mbledhjen tjetër ? Znj: Afrovi : Po.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi: këtë relacion e kërkojmë të na vi tri herë në vit dhe për mua 50% realizimi i të ardhurave është shumë mirë .Kryetari Bashkisë: është viti i parë që të ardhurat mbledhen kaq, është e kënaqshme dhe dua t'i përgëzojë punonjësit.

Pika 4 e rendit të ditës.

Shqyrtimi i projektvendimit për disa ndryshime në buxhetin faktit të Bashkisë Himarë me propozim dhe kërkesë të NSHP .

Këshilltarja Silva Burbo :- Komisioni u mbledh dhe ne na mungonte specialisti i zyrës përkatëse sepse këtu ka zëra që do të bëhen ndryshime në buxhet , pse duhet t'i bëjmë këto ndryshime? Sqaron Kryetari Bashkisë: Juve si këshill keni miratuar dy buxhete edhe të Bashkisë edhe të ndërmarrjes dhe ky ndryshim bëhet brenda buxhetit të ndërmarrjes ,

ndërmarrja është më vete por është krijuar dy muaj më vonë nga miratimi i buxhetit , dhe na duhet fonde për mirëmbajtjen e shërbimeve .

Këshilltari Qirjako Mërkuri : ndërmarrjes të shërbejë edhe në Borsh

Këshilltarja Silva Burbo : psh: mirëmbajtja e kamerave të godinave, pse e sollët në buxhet? Dua një sqarim për këtë ndryshim meqë se është bërë për donator dhe tani na thoni që do të bëhet nga ndërmarrja. Sqaron Kryetari Bashkisë : Ndryshimin e zërave e miratoni ju të nderuar këshilltarë, unë dua të punojmë , të punohet, dhe me këto fonde që nuk investohen le të kalojnë ndërmarrjes në shërbim të Bashkisë.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani : Shtatë punonjës për çfarë do t'i shërbejnë ndërmarrjes ?

Sqaron Kryetari Bashkisë : Kërkojmë rialokim për punonjës shtesë dhe ne e di që për tre muaj ndërmarrja nuk ka punuar me lekë dhe ky fond dihet të përdoret dhe këta shtatë (7) punonjës do të përdoren për fluksin e turizmit , për pastrimin sepse jemi vonë , nuk e prisnim kaq shpejt fluksin , sivjet fillojë më shpejt, duhet ti paraprijmë situatës në mënyrë që të nderohet.

Këshilltari Milto Nika: Lidhur me fondet që jep bashkia në lidhje me grumbullimin e makina, bashkua t'u tërheq vëmendjen punonjësve sepse nuk punojnë , për investimet përgëzoj këshillin për fshatin Sasaj për investimin e rrugës , përgëzoj edhe firmën për cilësinë e punës në rrugë.

Këshilltari Qirjako Mërkuri : kam vërejtje për investimet që janë bërë në borsh në linjat e dritave , ujit, firma I ka lënë kanalet hapur dhe inertet aty. Sqaron Kryetari Bashkisë :- Ju kam kërkuar llogari drejtuesve të firmës dhe nuk do të toleroj , çdo gjë do ta kthejnë në gjendjen e parshme. Investimet çu ecin mirë në Sasaj, Lukovë , në Stefanel nga ku është lënë puna do ta marrë përsipër NSHP.

Kryetari këshillit : E hedhim në votim, sa janë pro?

Sa janë kundër ?

Miratohet vendimi për disa ndryshime në buxhetin faktit me kërkesë të drejtorisë së ndërmarrjes , me nr. 24 vendim, me 15 vota pro, 2 kundër (Silva Burbo, Thëllëza Kokaveshi) 1 abstenim

Pika 5 e rendit të ditës

Shqyrtimi i projektvendimit “ mbi transferimin në pronësi të ujësjellës – Kanalizime shoqërisë rajonale Sh.A Vlorë , ujësjellësi Kallarat, ujësjellësi Kuç , ujësjellësi Bolenë.

Diskutime në këshill.

Komisioni e shqyrtoi si material por nuk doli me ndonjë raport apo procesverbal, u kërkuar të mos futej në rend dite, nëse 1/3 e këshillit e propozon për ta shqyrtuar këtu dhe për ta hedh në votim, jeni dakort?

Këshilltari Timole Gërdhuqi: ne jemi njohur me materialin , dhe komisioni nuk vendos e as ka të drejt të votojë , çdo material diskutohet në këshill, e shqyrtojmë këtu , nëse ka mangësi nuk është kompetencë e këshillit. Unë si këshilltar kërkoj që të gjithë kryetarët e fshatrave dhe

administratorët të japin propozimet e tyre për këtë çështje, sepse kjo prek komunitetin e tyre. Atëherë ngelet për mbledhjen e radhës edhe ky material:- Kryetari këshillit, këshilltarët.

Pika 6, 7, 8 , nuk kaluan në komision shprehet Kryetari këshillit .

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- Administrata të na sjell materiale të plota sepse ndaj kemi krijuar një grup ku e menaxhon sekretarja e Këshillit dhe ndaj shkruajmë aty për mbavajtjen e këshillit me badhkinë . **Kryetari këshillit :** Pikat që nuk u diskutuan sot I lëmë për mbledhjen e radhës.

Të ndryshme

Kryetari këshillit lexon kërkesën e z. BESNIK ZENELAJ , nga fshati Vranisht , I cili I drejtohet kryetarit të Bashkisë dhe këshillit bashkiak në lidhje për ndihmë financiare pasi ka djalin të smurë në spital në Athinë . **Kryetari Bashkisë:** I urojmë shërim të shpejtë djalit dhe kërkesën do ta trajtoj drejtoria përkatëse , ta shikojmë si I trajton ligji këto çështje dhe do ta sjellim në mbledhjen e radhës si projektvendim nëse e parashikon ligji.

Kryetari këshillit : Unë propozoj secili këshilltar të dhuroj një muaj nga shpërblimi tij , ndërsa unë do të dhuroj 500 euro të vjetra për djalin e zotërisë. (heshtje shumica e këshillit për propozimin)

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- Unë propozoj të përgjysmohet fondi këshillit , nga 10 milion të shkojë 5 milion të vjetra.

Pyetje nga qytetarët e bashkisë.

Diskutime për nivelin e gjobave të makinave

Kryetari Bashkisë: herës tjetër në bazë të kërkesave tuaja do të sjellim një projektvendim për nivelin e gjobave të makinave.

Kërkesë e Indrit Memaj, nga fshati Bolenë : Kërkon largësi të stafeve nga banesa e tij sepse është shqetësuese.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- Nuk është kompetencë e këshillit .

Ankesë nga banor i Bashkisë Himarë : Zoti kryetar kemi marr vesh që do të jepen prona iligjarkëve, ju lutem të trajtohen njëherë me prona banorët e bashkisë pastaj të huajt.

Ankesë nga banor i bashkisë : është herë e parë që vijë në dëgjuesë të këshillit dhe juvplrgëzoj që keni polemika me njëri – tjetrin , por për plazhin publik nuk jam dakort që është zënë këti në Himarë në qendër . Sqaron Kryetari Bashkisë, askush nuk e ka zënë, për mua është plazh publik .

Këshilltari Timole Gërdhuqi :- ju lutem drejtorive të na I sjellin materialet këshillit brenda afateve ligjore. Po- kryetari Bashkisë.

Kryetari këshillit : Mbledhken e deklarojë të mbyllur.

Sekretari

ELENA MEMUSHAJ

Adresa: Rr. "25 Nëntori", Nr. 1, Sh. 1, Himarë

Web: www.himara.gov.al, E-mail: info@himara.gov.al